

AKT THEMELIMI i SHOQERISE “Andi Pajisje Sportive” Sh.p.k

Akt Themelimi

I shoqerise tregtare “Andi Pajisje Sportive” SH.P.K.

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 “Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit”, te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, “Per shoqerite tregtare” dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 “Per Q.K.B dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare, me vullnetin e tyre te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi, ne ortaket themelues:

1. Ortaku themelues Z. Andi Kullolli, zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1.000.000 Leke (nje milion lekë) që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues Zj. Ilva Kullolli, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 1.000.000 Leke (nje milion leke), qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Formulimi

Neni 1

Sot me date 19.08.2025, formohet shoqeria tregtare private e quajtur “Andi Pajisje Sportive” SH.P.K. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqipetar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues .

Selia e Shoqerise

Neni 2

Durres, Lagja nr 16, Rruga Koco Kazanxhi, Nr pasurie 2/1029N23, Vol 86, Faqe 26, Zone Kadastrale 8513

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese dhe ortakeve te saj.

Objekti i Veprimtarise

Neni 3

Import- Export dhe shitje te pajisjeve sportive, aksesore sportiv, pajisje fitnesi, produkte rekreative, pajisje fizioterapie, aksesore futbollit, produkte kancelarie, vegla pune, makineri shendetit, produkte mjekesore, mallra industriale, mjete shkollore, veshje sportive, produkte rrobaqepsie, produkte plastike, gomine, elektrike, ekrane te ndryshme, reklama etj.

Kohezgjatja e Shoqerise


Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar. Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkakut.

Kapitali i Shoqerise

Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 2.000.000 lekë (dy milion Lekë)



1. Ortaku themelues Z. Andi Kullolli, zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1.000.000 Leke (nje milion lekë) që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues Zj. Ilva Kullolli, zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1.000.000 Leke (nje milion lekë) që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë

Drejtimi i Shoqerise

Neni 6

Ortakët e shoqërisë ka vendosur që shoqëria të drejtohet nga zj. Ilva Kullolli, shtetas Shqiptar me nr ID J36105033F si administrator dhe i cili do të jetë dhe përfaqësues ligjor i saj, për një periudhë 5-vjeçare. Ai është përfaqësues i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretet dhe ka kompetencë të plotë në drejtimin e saj. Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.

Neni 7

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve.

Neni 8

Ortakët kanë të drejtë të emerojnë dhe administrojnë të tjerë të vlerave materiale.

Kanë të drejtë të caktojnë financiare, likuidator për problemet e shoqërisë si dhe të pajtojnë persona të tjerë si ortakë.

Neni 9

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Neni 10

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Krijimin e Shoqërive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

Neni 12

Akti i themelimit u perpilua në 2 kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "Andi Pajisje Sportive" SH.P.K.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët.

Ortakët themelues:

Andi Kullolli

Ilva Kullolli